



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

**NJOFTIM PËR MEDIA**

Ditën e martë, në datën 16 shkurt 2021, në mjediset e AMA-s, u zhvillua mbledhja e radhës së Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

<b>Gentian</b>	<b>SALA</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Sami</b>	<b>NEZAJ</b>	<b>Zëvendëskryetar</b>
<b>Agron</b>	<b>GJEKMARKAJ</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Gledis</b>	<b>GJIPALI</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Suela</b>	<b>MUSTA</b>	<b>Anëtar</b>

AMA pasi shqyrtoi çështjet e rendit të ditës, vendosi:

1. Dhënien e licencës së transmetimit audio analoge rajonale, shoqërisë “ABEG” sh.p.k., për subjektin audio “Radio ST”, për të mbuluar me sinjal audio “Qarqet Tiranë dhe Durrës”. **(Vendimi nr. 21, datë 16.02.2021)**
2. Konstatimin e pavlefshmërisë së licencës së subjektit person fizik Irakli Stefani, për subjektin audioviziv “TV Tele Joni”. **(Vendimi nr. 22, datë 16.02.2021)**
3. Heqjen e autorizimit të shoqërisë “Triangle Media Group” sh.p.k., për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv mbështetur në internet OTT “City Tv”. **(Vendimi nr. 23, datë 16.02.2021)**
4. Rinovimin e licencës së shoqërisë “SCAN” sh.a., për subjektin audio privat vendor “Radio Scan”, dhe miratimin e ndryshimeve të ndodhura në strukturën e pronësisë së subjektit. **(Vendimi nr. 24, datë 16.02.2021)**
5. Rinovimin e licencës së shoqërisë “BIG FM” sh.p.k., për subjektin audio privat vendor “Radio +2”, dhe ndryshimin e kushteve teknike të licencës së subjektit. **(Vendimi nr. 25, datë 16.02.2021)**
6. Pajisjen e shoqërisë “Media +” sh.a., me licencë shërbimi programi audioviziv “Tv Shijak”, për qarqet Tiranë, Durrës dhe Elbasan”. **(Vendimi nr. 26, datë 16.02.2021)**
7. Mosrinovimin e autorizimit të shoqërisë “Intel Media” sh.p.k., për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve “Tv kabllor Jug”. **(Vendimi nr. 27, datë 16.02.2021)**
8. Pranimin e kërkesës së subjektit person fizik Edmond Manja, autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv kabllor Vaqarr”, për ndryshimin e emërimit të subjektit kabllor nga “Tv kabllor Vaqarr” në “MY NET-TV EDMA”. **(Vendimi nr. 28, datë 16.02.2021)**
9. Saktësimin e vendimit të AMA-s nr. 195, datë 06.09.2016 “Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Tring TV” sh.a., autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audio dhe audioviziv të të tretëve mbështetur në internet (IPTV)”. **(Vendimi nr. 29, datë 16.02.2021)**

AMA në këtë mbledhje ra dakord që subjekteve debitorë t'u caktohet afat 30 ditor për shlyerjen e pjesës së mbetur të detyrimit financiar.

Projektvendimi "Mbi ndryshimet e ndodhura në strukturën e pronësisë së shoqërisë "Channel One" sh.p.k., për subjektin audioviziv privat "TV Ora News", shtyhet në mbledhjen e radhës së AMA-s, që të shqyrtohet edhe dokumentacioni shtesë i depozituar nga shoqëria "Channel One" sh.p.k.

## **AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE**

**Tiranë, më 16.02.2021**